



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.983/1 Prot.

Tiranë, më 13/07/ 2020

V E N D I M

Nr. 70, Datë 13 /07/ 2020

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën Nr.59 Regj, datë 24.06.2020, paraqitur nga një grup personash dhe konkretisht znj.Dh.H, znj.I.K, znj.B.Ç, znj.M.E dhe znj.A.I, kundër zj. M.K, deputete e Partisë Socialiste në Kuvendin e Shqipërisë, me pretendimin për diskriminim për shkak të gjinisë, gjendjes shoqërore, gjendjes civile. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Me datë 02.06.2020 në Mbledhjen e Aleancës së Grave Deputete, me rend dite: “Dhuna ndaj vajzave dhe grave gjatë periudhës së pandemisë”, zj.M.K, në fjalën e mbajtur përdori fjalë fyese dhe fjali diskriminuese duke i përcaktuar specifikisht me termin jo zyrtar “zyshat” mësueset dhe bërë qartas dallimin : *“Zyshat tona sot e kanë mendjen për të bërë të tjera punë nuk kanë mundësi të bëjnë dhe ditarin tërë ditën, të lyejnë dhe buzët, sytë, vetullat e flokët dhe thonjtë funde e minifunde. Zyshat tona kanë qenë të pamartuara pa fëmi dikur, pa sot nuk kuptohet fare kush bëhet zonjushë pale kush bëhet roje. Do ta marrim këtë situatë në dorë apo do bëjmë sikur flasim sa bukur, sa bukur”*.

Fjala e zonjës M.K është transmetuar në edicionet e lajmeve të asaj dite në televizion, median e shkruar, portale dhe rrjetet sociale. Kurse në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë është hequr ky diskutim nga linku i mbledhjes së AGD. Ne i kemi bashkangjitur ankesës linqet përkatëse, fotokopje të artikujve dhe reagimin e mësuesve të indinjuar dhe të fyer, nga dallimi dhe etiketimi duke bërë qartas diskriminim gjinor, shoqëror, të gjendjes civile, të figurës dhe dinjitetit të tyre.

¹Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Fjala e zonjës M.K ka shfaqje të diskriminimit të mësuesve, bazuar në ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Disa argumente :

Sipas statistikës zyrtare të INSTAT-it gjatë vitit shkollor 2017-2018 kanë punuar në arsimin parauniversitar 33771 mësues, ku gati 70% kanë qenë femra dhe 30% meshkuj. Pak a shumë këto të dhëna qëndrojnë edhe për vitin shkollor 2019-2020. Pra në arsim punojnë dhe femra edhe meshkuj. Deputetja M.K ka bërë qartas dallim dhe në diskutimin e saj ka nxjerrë përgjegjës për situatën e abuzimit seksual të vajzës vetëm “zyshat” një emërtim jo zyrtar për mësueset. Gjithashtu ka bërë edhe një krahasim me mësueset e hershme që kanë qenë beqare (!)(diskriminim i gjendjes civile). Ajo nuk ka folur në mënyrë specifike për të gjithë përgjegjësit e kësaj situate, sigurisht dhe stafit drejtues dhe pedagogjik të shkollës ku studionte vajza e ngjarjes në diskutim, por vetëm për “zyshat”.

Mësuesit/et gjatë periudhës së pandemisë kanë punuar me të gjithë energjitë (sikundër gjatë gjithë procesit mësimor që është zhvilluar në shkollë), mënyrat e mësimi online, me orare të zgjatura gjatë gjithë ditës. Mjaft mësues/mësuese janë përfshirë në dhënien e leksioneve për nxënësit edhe në TV dhe në kanalin youtube. Fjalimet e ministres së MARS-së, zonjës B.Sh, si dhe faqja e saj zyrtare në rrjetin social facebook e pasqyrojnë këtë vlerësim të punës dhe performancës së mësuesve gjatë periudhës së pandemisë. Edhe për rastin në fjalë MARS-ja ka marrë masat përkatëse.

Gjithë sistemi shkollor ka një kod etike, akte ligjore, rregullore të shkollës, ne mësueset/it i respektojmë, përkushtohemi dhe marrim përgjegjësitë tona në lidhje me realizimin e qëllimit të shkollës, përcaktuar në Ligjin e arsimit parauniversitar nr. 69/2012, ku në qendër të gjithë edukimit, mësimdhënies dhe nxënies janë nxënësit. Edhe Kuvendi i Shqipërisë ka një Kod Etike, ku sipas mendimit tonë, zonja M.K e ka shkelur nenin 6/b me këtë fjalim të shkurtër në mbledhjen zyrtare të AGD.

Pas reagimeve të mësueseve në rrjetet sociale, zonja M.K në datën 6 qershor ka vazhduar qëndrimin e saj dallues, diskriminues, në faqen e saj në facebook. Edhe në këtë reagim, ashtu si dhe në seancën e sipërcituar, ajo nuk është mbështetur në asnjë studim ankete me referencë konkrete zyrtare, por vetëm në referencat personale.

Në, një grup mësuesesh, me një përvojë mbi 20 vjet në arsim parauniversitar, përvojë si trajnere në fushën e edukimit, koordinatorë në rrjete dhe programe ndërkombëtare të shkollave, hartues tekstesh shkollore, shkrimesh e botimesh të ndryshme, ndihemi të ofenduar nga vlerësimi i zonjës M.K dhe mendojmë se fjalët e saj përbëjnë objekt diskriminimi që duhet të trajtohet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bazë të ligjit me të cilin ju vepron. Ankueset kërkojnë nga Komisioneri:

- Marrjen e masave të parashikuara nga neni 33, pika 12, gërma “ç” të ligjit nr. 10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”
- Zonja M.K të kërkojë ndjesë publike.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1, të Ligjit Nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me **gjininë**, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, **gjendjen** ekonomike, arsimore ose **shoqërore**, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, **gjendjen civile**, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Bazuar në nenin 4, të ligjit Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: “1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.”

Bazuar në nenin 32, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: “1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;”

Bazuar në nenin 33, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: “1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.”

Bazuar në nenin 33, pika 4, të Ligjit nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) është anonime; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta

çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt.”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të Ligjit nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Bazuar në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;”

Bazuar në nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Bazuar në nenin 33, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: përcaktohet se: “1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura admini-strative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative. 2. Në procedurën administrative janë gjithashtu palë edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këta interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative.”

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës dhe mbështetur në faktet dhe pretendimet e parashtruara nga ankueset, Komisioneri vlerëson se bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b” të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ankesa nuk duhet të pranohet si e papajtueshme me dispozitat e ligjit, për arsye të mëposhtme:

Bazuar në nenin 4, të Ligjit “Për mbrojtjen nga Diskriminimi” të marrë së bashku me nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, janë subjekte të ligjit dhe mund t’i drejtohen Komisionerit të gjithë personat fizikë dhe juridikë, si dhe çdo subjekt i së drejtës i parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Nenet 32/a dhe 33/1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i njohin të drejtën çdo personi ose grupi personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose organizate me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, për të paraqitur ankesë para Komisionerit. Këto dispozita të marra së bashku me nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, kërkojnë që një person ose grup personash të kenë një interes legjitim të

drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative. Pra në rastin konkret, që ankueset të legjitimohen si palë në procedurën administrative para Komisionerit duhet që të kenë një interes legjitim të drejtëpërdrejtë.

Ankueset, të cilat pretendojnë se janë mësuese, kanë denoncuar faktin se, zonja M.K, në Mbledhjen e Aleancës së Grave Deputete, me rend dite: “*Dhuna ndaj vajzave dhe grave gjatë periudhës së pandemisë*”, mbajtur në datë 02.06.2020, në fjalimin e saj të mbajtur në këtë mbledhje ka përdorur fjalë fyese dhe diskriminuese për mësueset, duke bërë diferencë në trajtim për shkak të gjinisë në raport me meshkujt që ushtojnë profesionin e mësuesit, por edhe diskriminuese për mësueset për shkak të gjendjes civile dhe gjendjes shoqërore.

Komisioneri vëren se, në këtë ankesë, ankueset nuk janë synuar personalisht në fjalimin e zonjës M.K, por fjalët dhe shprehjet e përdorura kanë të bëjnë me kategorinë e mësuesve në përgjithësi. Në këtë mënyrë ankueset nuk provojnë se kanë një interes të drejtëpërdrejtë dhe personal. Ankueset nuk mund t’i drejtohen Komisionerit për të arritur respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave apo interesave publike që i drejtohen një komuniteti në tërësi apo një grupi shoqëror.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankueset duke mos patur një interes legjitim të drejtëpërdrejtë dhe personal nuk kanë legjitimitet aktiv për të paraqitur këtë ankesë.

Së dyti: Komisioneri vlerëson se bazuar në nenin 4 , pika 1, të Ligjit Për mbrojtjen nga diskriminimi dhe nenin 33, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, legjitimohen për të qenë palë në procedurën administrative para Komisionerit edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen. Në këtë kuptim, për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave apo interesave publike në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit, legjislati në fuqi ka legjitimuar për të qenë palë në një procedurë administrative, mbajtësit e interesave publike/kolektivë, që mund të jenë organizata të ndryshme shoqërore të njohura me ligj dhe që kanë si qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut, komunitete fetare, sindikata, etj.

Në këtë kontekst, është praktikë e Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që kur shqetësimi apo diskriminimi i pretenduar nuk i adresohet personalisht një personi, por prek një komunitet në tërësi, pra cenon interesa kolektivë apo publikë, ankesa të formësohet nga një organizatë me interes të ligjshëm dhe jo nga çdo individ.²

² Vendimi Nr.62, datë 17/06/2020, Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, Qendra për Advokim Social, Qendra për Aksion Komunitar dhe Qendrea T’reja, kundër Deputetit të Kuvendit, z. M. M;

Vendimi Nr.63, datë 17/06/2020, Shoqata “Disutni Albania”, “Lëvizja për Mbrojtjen e të Drejtave Rome” dhe “Amare Roma”; kundër Deputetit të Kuvendit, z. M. M;

Vendimi Nr. 64, datë 17/06/2020 Shoqata “Rromano Kham”, kundër Deputetit të Kuvendit, M.M;

Vendimi Nr.15, datë 30/01/2019, Shoqata Ilinden, kundër Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”;

Vendimi Nr.36, datë 05/03/2019, Fondacioni Down Sindrome Albania kundër Bio Save Tirana;

Vendimi Nr.120, datë 09/09/2019, Fondacioni Down Sindrome Albania kundër Deputetit të Kuvendit, z. M.M.

Vendimi Nr.125, datë 01/08/2014, Shoqata “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT” dhe Shoqata “Të bashkuar pro kauzës LGBT”, kundër subjektit politik Aleanca Kuq e Zi.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, çështja në fjalë është një çështje që i përket interesit publik dhe nuk ka të bëjë me interesin e drejtëpërdrejtë dhe personal të ankueseve. Në këto kushte për të bërë një ankesë para Komisionerit do të legjitimoheshin subjektet që janë mbajtës të interesave kolektive apo interesave të gjerë të publikut në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Komisioneri nuk mund të mos theksojë faktin, se çdo lloj fjale apo shprehje me natyrë përgjithsuese dhe paragjyquese për grupime të caktuara të shoqërisë apo që bazohen në cilindo nga shkaqet e mbrojtura nga Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk promovojnë barazinë. Paragjykimet mund të dëmtojnë grupe të caktuara të shoqërisë, e veçanërisht grupe vulnerabël të shoqërisë që historikisht kanë vuajtur nga përjashtimi dhe diskriminimi, duke i marginalizuar ose cenuar dinjitetin e tyre njerëzor.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe për rrjedhojë ankesa nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, nenin 33, pika 4, gërma “b”, nenin 33 pika 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me Nr.59 Regjistri, datë 24.06.2020, të paraqitur nga znj.Dh.H, znj.I.K, znj.B.Ç dhe znj. M.E dhe znj. A.I.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjinia, Gjendja shoqërore, Gjendja civile
Fusha: Gjuhë diskriminuese
Lloji i vendimit: Vendim mospranimi